

## **Vendosja e objektivave dhe përzgjedhja e materialeve**

### **Fletë pune 2: Dy grupe materiale në EQD/EDNJ**

Mësimdhënia dhe të nxënit pa materialet e duhura është e pamundur, sepse materialet janë media që jep lëndën, temat, informacionin dhe të dhënat. Nxënësit zhvillojnë kompetencat e tyre nëpërmjet aktiviteteve, që do të thotë ata "bëjnë diçka" me një objekt. Ajo që të vjen fillimisht në mendje në këtë drejtim është ndoshta teksti shkollor ose një manual dhe ato janë me të vërtetë të rëndësishëm në EQD/EDNJ.

#### **Dy kategoritë e materialeve në EQD/EDNJ**

Megjithatë, profili i veçantë i EQD/EDNJ pasqyrohet në larminë e madhe të materialeve dhe medieve. Teksti shkollor dhe manuali janë shembuj të mediave të shtypura. Në të mësuarit ndërveprues konstruktivist, një kategori tjetër e materialeve krijohet nga mësuesi dhe nxënësit. Ato janë autentike, pasi janë materiale të dorës së parë, të prodhuara në vend, në një situatë të veçantë, për njerëzit e pranishëm në atë kohë dhe atë vend. Në EQD/EDNJ, mësuesit dhe nxënësit nuk janë vetëm përdoruesit e materialeve, por edhe prodhuesit e tyre. Vëllimet nga II deri VI të këtij botimi të EQD/EDNJ japin shumë shembuj për këtë kategori materiale, shumë shpesh të krijuara nga nxënësit në kushtet e të nxënit të bazuar në detyra ose në projekte dhe njësitë mësimore dhe përshkrimi i mësimit eksplorojnë potencialet e tyre të pasura mësimore për nxënësit.

#### **Një matricë e kërkesave dhe materialeve të mësimit**

Matrica e mëposhtme lidh disa shembuj tipikë për këto dy kategori të materialeve – të dhëna nga media dhe të prodhuara në proceset e bashkëveprimit që përfshijnë mësuesit dhe nxënësit – me aspekte të ndryshme të zhvillimit të kompetencave në fushën e EQD. Ne nuk rekomandojmë asnjë lloj paragjykimi për ndonjë lloj materiali, por më tepër sugjerojmë një qasje të integruar. Megjithatë, mësimi përmes demokracisë dhe të drejtave të njeriut kërkon nga mësuesit që të marrin seriozisht produktet e krijuara nga nxënësit.

Aspekte të zhvillimit të kompetencës	Materiale të transmetuara përmes medias	Materiale të prodhuara në procesin e të mësuarit	
		Materiale të prodhuara nga mësuesit	Materiale të prodhuara nga nxënësit
Zhvillimi i mëparshëm i nxënësve	Materiale të tilla ekzistojnë edhe në media, për shembull, libra ose filma fëmijësh, por ato janë jashtë kuadrit të perceptimit të mësuesit		Njohuri paraprake, përvoja e mëparshme dhe procesi i socializimit në familje ose me bashkëmoshatarët, informacione të përftuara më parë, brenda dhe jashtë shkollës
Përcaktimi i një teme, planifikimi i mësimit ose temës			Ushtrime për nxehje truri dhe diskutim i të dhënave paraprake
Informacioni	Raportime aktuale të lajmeve (media e shkruar, TV, DVD, Internet) Tekste shkollore	Leksione  Ofrimi i materialeve bazë (tabela me fleta, lapustila, letër me ngjyra)	Të dhëna të nxënësve (dekonstruksioni (zbërthimi) i mesazheve të transmetuara përmes medias, përmbledhje, detyra për t'u ndjekur, prezantime, argumente dhe debate në diskutim, komente, pyetje)
Analiza dhe gjykime	Çështje dhe keqkuptime në politikë dhe shkencë (fletë pune, tekste shkollore)	Udhëzime për konceptet kryesore Kritikat që kërkojnë dekonstruktivitet	
Trajnimi i aftësive	Fletë pune (udhëzime trajnimi)	Demonstrimi dhe stërvitja	Marrje e reagimeve
Pjesëmarrja dhe veprimi		Drejtimi i një sesiioni	Përvojë  Pyetje, komente, thellim, interesa
Vlerësimi dhe pikëzimi	Fletë testimi  Pyetësorët  Plane mësimore	Vëzhgime	Vetëvlerësimi  Reagimet  Shprehja e nevojave të mësimit